

DPK/DMP

03-551/2013

1

OZ

21.02.2013

K. nr. 6066/2011

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NE SUHAREKE - DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE**, Gjyqtari – Durmish Berisha, me sek. juridike – Ajnishahe Berisha, ne proceduren e kundervajtjes ndaj te pandehurit: **Ilirian Rilind Bytyqi nga fsh. Studenqan K Suharekë**, per kundervajtjen e kryer nga nen 6 e qe sanksionohet ne baze te nenit 16 paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrëtarëve të Lartë Publik, si dhe ne bazë te nenit 73, 195 dhe 199 te Ligjit mbi kundervajtjet me dt. 19.02.2013, merr ketë:

#### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:** Ilirian Rilind Bytyqi nga fsh. Studenqan K Suharekë, i lindur më 04.06.1968, ka të kryer shkollen e mesme, i martuar baba i 4- fëmijëve, me profesion, Drejtor i Inspeksionit dhe Administratës, gjer me tani kinse jo i denuar.

#### E S H TË P E R G J E G J E S

Per arsy se Zyrtari I Larte Publik nuk e ka permbushur obligimin ligjor mbrenda afatit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave te Zyrtareve te Larte Publik ne pajtim me nenin 6 te Ligjit me nr. 03/L-151.

Me kete veprim i pandehuri ka kryer kundervajtje nga nen 6 e qe sanksionohet ne baze te nenit 16 paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrëtarëve të Lartë Publik, e me aplikimin e të njejtit.

#### G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej **400 (Katërqind) €**, gjobën e shqiptuar duhet ta paguaj pas plotefuqishmerise së ketij Aktvendimi, në favor te Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në xhirologarin nr.1000430070000518, e që pagesa bëhet permes kësaj gjykate.

Nese gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njejti do ti zëvendesojet me denim burgimi ne kohëzgjajte prej **26 - ditesh**, duke iu llogaritur nga **15 €**, per një ditë burgimi.

I pandehuri është i obliguar që në emer të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën paushalle prej **10 - €**, në afatin e njejtë sikurse gjobën e shqiptuar në të holla nën kërcnim të ekzekutimit me dhunë.

Me nga nje kopje të ketij aktvendimi duhet njoftuar parashtuesin e kerkeses dhe të pandehurin.

#### A R S Y E T I M

Me kërkesen e **Agjensisë Kundër Korruptionit - Prishtinë** me nr. 01-3232/11 të dt. 14.07.2011, është ngritur fletparaqitja per kundervajtje kunder të pandehurit me motivacion se ka kryer kundervajtje.

03-551/2013/02  
fuz

2

Gjykata duke vepruar sipas udhezimeve te Gjykates se Apelit ne Prishtine - Divizioni per Kundervajtje, siguroj fletedorezimin nga Kuvendi i Komunes ne Suhareke leshuar nga Zyrtari Kontaktues me Agjensin / AKK, te dt. 21.03.2011, te nenshkuar nga I pandehuri , si dhe mori ne pyetje Zyrtarin e Larte per Mbikqyrjen e Pasurise nga AKK Enis Sadiku i cili deklaroj se: Eshte e vertete se Zyrtari i Larte nga Suhareka Drejtori i Administrates dhe Inspeksionit ka paraqitur deklarimin mbi prejardhjen dhe kontrollin e pasurise me dt. 04.07.2011, mirepo kete e ka bere me vonese, pas afatit te parapare me ligj, qka do te thote se ka kryer kundervajtje nga nenii 6 i Ligjit me nr. 03/L-151.

Gjykata pas administrimit te provave ne shkresat e lendet, deklaratës së të pandehurit, fletedorezimit te dt. 21.03.2011, te nenshkuar nga I pandehuri, e gjithashtu pas marrjes se deklarates nga parashtruesi i kërkeses, vertetoi, se i pandehuri me te vertete ka kryer kundervajtje nga nenii 6 e qe sanksionohet spas nenit 16 paragrafi 1.2 te Ligjit nr. 03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrëtarëve të Lartë Publik, e me aplikimin e të njejtit gjykata të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe ia shqiptoi denimin me gjobë në të holla ashtu si u cek në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata gjatë marrjes së këtij Aktvendimi pati parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese, të cilat ndikojnë në marrjen e këtij aktvendimi.

Me sa u cek me lartë u vendos si ne dispozitiv te ketij Aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NE SUHAREKE - DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE.**

Sek. Juridike

Ajnishahe Berisha



**UDHEZIME JURIDIKE:** Kunder këtij aktvendimi kanë të drejtë të përfshijnë pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykates së Apelit ne Prishtinë – Divizionit per Kundervajtje në afatin prej 8 ditesh, pas marrjes së të njejit. Ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj Gjykate.